



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI QARKU FIER

Nr. 1682/1 Prot.

Fier, më 25.11.2019

Lënda: Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit Bashkiak Roskovec.

Drejtuar: Znj. Majlinda **BUFI**
KRYETARE E BASHKISË ROSKOVEC.

Për dijëni: Z. Kadri **HYSKA**
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC.

ROSKOVEC

ROSKOVEC

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 6138 prot. datë 25.10.2019, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 1682 prot. Datë 29.10.2019, bazuar në Ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16, shqyrtuam vendimet e Këshillit Bashkiak Roskovec të marra në mbledhjen e datës 23.10.2019 si dhe dokumentacionin plotësues për vendimet si më poshtë:

Vendimi Nr. 89 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Roskovec" Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 49 pika 2, 4/b, 5.

Vendimi Nr. 90 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Mbi miratimin e fondit për pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe invalidëve të punës për periudhën 1-31 Tetor 2019" Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" datë 17.12.2015 neni 8 pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", Ligjin Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" neni 31 si dhe në zbatim të VKM Nr. 618, datë 07.09.2006 "Për



përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar"(i ndryshuar).

Vendimi Nr. 91 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për periudhën 1-30 Shtator 2019” Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8 pika 2, 9, 24; Ligjin Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21; VKM-në Nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5 datë 17.2.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%” (i ndryshuar).

Për Vendimin Nr. 92 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e rregullores urbane për bllokun Nr. 2, Qendër Roskovec” do të shprehem kur të sillni aktin e konformitetit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorrit pasi për bashkinë tuaj nuk ka ende nje Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar, bazuar në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorrit Nr.1 date 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi ,deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore” (i ndryshuar) pika 5 dhe Udhëzimit Nr.1, date 16.03.2017 “Për mënyrën dhe procedurat e zbatimit të planeve të përgjithshme vendore” i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2 datë 14.04.2017 pika 17.

Vendimi Nr. 93 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Ndërtimi i rrethrotullimit Qendër Roskovec” Ju kthehet si i paligjshëm në bazë të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” neni 109 shkronja “a” për moskompetecë të Këshillit Bashkiak bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) neni 12. Bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) neni 29 shkronja “a” duke qenë se projekti përmban punime ndërtimi vendimarrja në këtë rast është përgjegjësi e kryetarit të bashkisë. Bazuar në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorrit Nr.1 date 30.07.2017 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi ,deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, (i ndryshuar) pika 5, për këtë projekt ju duhet të vazhdoni procedurat me Agjencinë e Zhvillimit të Territorrit duke qenë se bashkia juaj nuk ka ende nje Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar.



Vendimi Nr. 94 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e fondit për “Projekt- Zbatimin dhe Preventivin përfundimtar për 8 Ujësjiellësa” Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe në zbatim Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Vendimi Nr. 95 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e ndryshimeve në strukturën e Bashkisë për vitin 2019” Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 54 gërma “dh”, Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligjin Nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe në zbatim Udhëzimin Nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Vendimi Nr. 96 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Ndërtimi i 4 Lulishte në Fshatin Velmish” Ju kthehet si i paligjshëm në bazë të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” neni 109 shkronja “a” për moskompetecë të Këshillit Bashkiak bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) neni 12. Bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) neni 29 shkronja “a” duke qenë se projekti përmban punime ndërtimi vendimmarrja në këtë rast është përgjegjësi e kryetarit të bashkisë. Bazuar në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1 date 30.07.2017 “Per percaktimin e rregullave dhe procedurave qe do te ndiqen nga autoritetet e zhvillimit te territorit per shqyrtimin e kerkesave per leje ndertimi ,deri ne miratimin e Planeve te Pergjithshme Vendore”, (i ndryshuar) pika 5, për këtë projekt ju duhet të vazhdoni procedurat me Agjencine e Zhvillimit te Territorit duke qene se bashkia juaj nuk ka ende nje Plan te Pergjithshem Vendor te miratuar.

Vendimi Nr. 97 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Ndërtimi i Parkut Agroturistik dhe rehabilitimi i rrugës hyrëse të Fshatit Luar” do te shprehemi kur te sillni aktin e konformitetit nga Agjensia e Zhvillimit te Territorit pasi per bashkine tuaj nuk ka ende nje Plan te Pergjithshem Vendor te miratuar, bazuar ne Vendimin e Keshillit Kombetar te Territorit Nr.1 date 30.07.2015 “Per percaktimin e rregullave dhe procedurave qe do te ndiqen nga autoritetet e zhvillimit te territorit per shqyrtimin e kerkesave per leje ndertimi ,deri ne miratimin e Planeve te Pergjithshme Vendore” (i ndryshuar) pika 5 dhe dhe Udhëzimit nr.1, date

16.03.2017 “Për mënyrën dhe procedurat e zbatimit të planeve të përgjithshme vendore” i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2 datë 14.04.2017 pika 17.

Vendimi Nr. 98 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e fondit për projektin “Qendra e Kujdesit Ditor PAK” Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe në zbatim Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Vendimi Nr. 99 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për përbërjen e Këshillit Vendor për sigurinë publike” Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 29 si dhe në zbatim Ligji Nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit” neni 11 pika 3 gërma “d” dhe neni 78 pika 2.

Vendimi Nr. 100 datë 23.10.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Miratimin e ndryshimit të destinacionit të përdorimit për subvencionin për vitin 2019 (603)” Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” dhe në zbatim Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”(i ndryshuar).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



PREFEKTI

Baki BALA